Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/572
Datë: 16.09.2024

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 04.09.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

1 **Akreditohet** Institucioni i kurseve të gjuhëve të huaja "Britannia Academy" L.L.C. me adresë: Rr. Shuaip Spahiu, 45, Prizren, Republika e Kosovës, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 03.09.2024 deri 02.09.2027, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar:

1.1 **Kurse të Gjuhëz Angleze**, Niveli A1 deri në C1 sipas KPERGJ.

2 Institucioni obligohet të plotësoj kushtet bazuar në vendimin e Këshillit Drejtues Nr.01/402 të datës 13.06.2024.

3 Obligohet Institucioni të sjellë planin e implementimit të rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve me afat prej 60 dite.

4 Obligohet AKK të bëjë monitorimin e përmbushjes së këtyre kushteve.

5 Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucioni i kurseve të gjuhëve të huaja "Britannia Academy" me datë 12.09.2023 ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim të institucionit për ofrim, vlerësim dhe certifikim të kursit për Gjuhë Angleze, Niveli A1 deri në C1 sipas KPERGJ. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve bazuar në dispozitat ligjore në fuqi nga fushëveprimtaria e AKK-së ka caktuar ekipin e eksperteve të jashtëm me qëllim të vlerësimit të institucionit lidhur me përmbushjen e kritereve për akreditim si më lartë.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit, me datë 19.06.2024 kanë realizuar vizitën në institucionin Britannia Academy, ndërsa me datë 15.07.2024 kanë përpiluar raportin vlerësues për akreditim për kualifikimin për të cilin institucioni ka parashtruar kërkesë për akreditim. Raporti vlerësues i ekipit të ekspertëve është proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 04.09.2024. Rekomandimi përfundimtar i ekipit të ekspertëve është mbështetur në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit si: aplikacioni për akreditim të institucionit, raportin e vetëvlerësimit dhe dëshmitë për plotësimin e kritereve të akreditimit të dorëzuar nga institucioni si dhe vizitën e realizuar tek pala aplikuese. Ekipi i ekspertëve në raportin vlerësues, bazuar në të gjeturat në dosjen e aplikimit dhe nga konstatimet me rastin e realizimi të vizitës tek Institucioni Britannia Academy kanë rekomanduar që institucioni të akreditohet.

Andaj, Këshilli Drejtues i AKK-së në bazë të kërkesës së Institucionit Britannia Academy për akreditim, rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhënat në raportin vlerësuese për akreditim për institucionin aplikues si dhe dispozitave ligjore të lartcekura, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.*

Vendimi u dërgohet:

1. Britannia Academy" L.L.C.
2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së